



Newsletter Shtator 2019



I dashur lexues,

Mirë se erdhe në numrin e parë të gazetës elektronike të Fondit Shqiptar të Zhvillimit! Vizioni i FSHZH është që Shqipëria mund të jetë një vend i zhvilluar në të gjitha drejtimet. Ne besojmë se Shqipëria është një vend i bekuar dhe ka një potencial të jashtëzakonshëm zhvillimi që duhet inkurajuar.

Kjo gazetë elektronike është një dritare e re komunikimi dhe informimi. Çdo muaj do të sjellim artikuj informues mbi qasjet dhe metodologjitë e reja që FSHZH sjell në proceset e veta, mbi ecurinë e projekteve madhore, si dhe mbi ndërhyrjet e investimet e reja që po përgatiten.

Pa një vëmendje të shtuar ndaj mjedisit zhvillimi i qëndrueshëm as që mund të mendohet. Po ashtu mirëqenia dhe siguria e njerëzve në punë është shumë i rëndësishëm për FSHZH. Prandaj mjedisi dhe siguria teknike do të kenë një hapësirë të veçantë me artikuj jo vetëm informues, por edhe ndërgjegjësues.

Çfarë po i sjellin vendit të gjitha projektet e financuara nga Qeveria Shqiptare dhe institucionet e huaja financiare? A po ndryshon diçka? Si po ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve? Njerëzit e thjeshtë përmes historive të tyre do të tregojnë si dhe sa është ndikuar jeta e tyre dhe e komuniteteve ku ata jetojnë.

Mendo për sigurinë, dikush të pret në shtëpi!

Sa herë ju ka ndodhur të kaloni rrugën ndërsa jeni duke folur në telefon pa e pasur plotësisht mendjen nëse ka makina që po afrohen? A keni qenë edhe ju një nga ata njerëz që duke kthyer një mesazh kanë goditur derën e xhamit të godinës nga e cila dilnin duke pësuar lëndime? A nuk ju ka ndodhur që duke nxituar për një takim pune në një ditë me shi keni rrëshqitur ndërsa ngjisnit apo zbrisnit shkallët?

Janë me dhjetëra rastet që mund të përmendim kur mendimet që na kalojnë në kokë, nxitimi për të mbërritur në orar në një takim apo përdorimi i celularit na shpërqëndrojnë dhe na bëjnë të harrojmë më të rëndësishmen: **SIGURINË**. Një incident mund të ndodhë brenda një çasti në çdo vend. Do të mjaftonte të mendonim pak më shumë për sigurinë që lëndimet të parandalohen. Siguria është shumë e rëndësishme, aq më tepër kur mungesa e saj ka një impakt negativ të lartë, jo vetëm për individin, por edhe për familjen dhe shoqërinë. Prandaj kjo çështje i përket jo vetëm individit, por të gjithëve.



Për më shumë info:
<https://www.albaniandf.org/hse/>

Infrastrukturë miqësore me mjedisin për zhvillim të qëndrueshëm

Mbrojtja e mjedisit është sfida e këtij shekulli.

Duke qenë se ditët e sotme janë rritur kërkesat për investime, veçanërisht në infrastrukturë dhe urbanizim studimi i impaktit mjedisor dhe social të projekteve është i nevojshëm.

Ky i fundit, një fazë e rëndësishme e programeve që Fondi Shqiptar i Zhvillimit zbaton, për llogari të partnerëve është gjithashtu një kriter që i paraprin hartimit të një projekti, për një objekt apo zonë të caktuar. Pasi qëllimi primar është minimizimi i impaktit negativ në mjedis, duke siguruar kështu kushtet, për një zhvillim të qëndrueshëm.

Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/2019/09/16/infrastruktura-miqesore-me-mjedisin-per-zhvillim-te-qendrueshem/>



Puka - Vizitoje, eksploroje, shijoje



Këtë vit ka nisur dhe është drejt përfundimit faza e dytë e ndërhyrjeve për rikualifikimin urban të Pukës. Me financim të Qeverisë Shqiptare dhe Bankës së Këshillit të Evropës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit po zbaton ndërhyrjet në rrugët lidhëse të spitalit, kapotimin e fasadave të objekteve pranë shesheve, forcimin e mbrojtjes së liqenit të vogël, si dhe ndërhyrje plotësuese në parkun pranë ish-Hotel Turizmit.

“Pukën e kam njohur pak në fillim, 3 vite para se të vija të investoja prindërit e mi i sillja këtu te një shoku im. Klima ju bëri shumë mirë, pastaj nisa investimin, projektet vazhduan dhe ja ku jemi sot. Me lekun tim, me Investimin tim me djersën e ballit, kam investuar në një qytet në vendin tim. Gjëja më e mirë që kanë bërë, se kanë bërë plot në fakt është sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza dhe të bardha. Duke ruajtur ujërat e burimeve nga mali i Tërbunit”. *Xhim Begeja*

“Kemi nisur fillimisht nga grupe të vogla, nga tradita më shumë në kushte të vogla familjare, nga investimet tani grupet janë organizuar. Ka dhe laboratorë tani. Ne më shumë jemi të përfshira në prodhim ku secila nga zonat, prodhon një reçel të caktuar si psh reçel boronice, reçel kumbulle, etj. Tashmë jo në enë plastike, kemi filluar në qelq se është më e sigurt dhe ruhet më shumë për qytetarin”. *Zonjat e Munellës*

“Vjet në Shqipëri ka patur 15-20 mijë turistë francezë. Që tani, kemi sërish prenotime për vitin tjetër, familje që do t'i presim këtu në Pukë. Merr shembull këtu/ Thana është një produkt që nuk ekziston në Francë, është shumë e rëndësishme kjo. Zonat e Evropës nuk e njohin fare, keni mundësinë të prezantoni gjëra unike. Apo glikotë janë super i blejnë dhe për dhurata kur kthehen në vendin e tyre”. *Berenger Tibout*



Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/2019/09/24/puka-vizitoje-eksploroje-shijoje-kthehu-me-miqte/>

Valbona - Modeli i ri i menaxhimit cilësor të turizmit

Qendra e turizmit në Valbonë është rikonceptuar totalisht nga e para, si një qendër multifunksionale. Ndërhyrjet konsistojnë në:

- Rikonstruktion i plotë i 2 objekteve si dhe ndërtimi i 4 bungalow për t'iu përgjigjur nevojave në kohën e pikut turistik
- Ndërtimin e një dyqani për të promovuar zonën
- Hapjen e një zyre informacioni turistik



Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/projekte/projekte-ne-zbatim/programi-punet-ne-komunitet-iv-zhvillimi-i-alpeve-shqiptare-dhe-zones-bregdetare/>

Qyteti i “40 shenjtorëve”, së shpejti nis projekti i modernizimit!

Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të fillojë ndërhyrjen për rigjenerimin urban të shëtitorës “Naim Frashëri” në Sarandë. Synimi kryesor është integrimi në infrastrukturën ekzistuese urbane të elementëve që përmirësojnë peizazhin urban, lehtësojnë lëvizjen e njerëzve dhe krijojnë hapësira të dedikuara për aktivitete të ndryshme.



Për më shumë info:

<https://www.albaniandf.org/2019/08/30/qyteti-i-40-shenjto-reve-se-shpejti-nis-projekti-i-modernizimit/>

Ja çfarë ka pas Tamarës

Sipas gojëdhënave Tamara e ka marrë emrin nga bashkëshortja e Pashait të Shkodrës, Karamahmut Pashë Bushatliut. Në nder të saj Pashai ndërtoi fillimisht urën e Tamarës që i dha më vonë emrin zonës. Fondi Shqiptar i Zhvillimit në kuadër të programit Punët në Komunitet IV: “Zhvillimi i Alpeve dhe Zonave Bregdetare” financuar nga Qeveria Shqiptare dhe Banka e Këshillit të Europës, po vijon zbatimin e fazës së dytë të projektit për rehabilitimin e qendrës Tamarë, rikonstrukcionin e rrugës Vermosh - Doganë, mbrojtjen lumore dhe urën mbi përroin e Budacit.

A e dini se?

